



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I STATISTIKËS DHE
INFORMATIKËS SË ZBATUAR



Miratoi

Prof. Dr. DHORI KULE

Dekan

Program Mësimor

Lënda: Metoda Kërkimi

Programi i Studimit: Master i Shkencave në Degën Sisteme Informacioni në
Ekonomi, kohë e plotë.

Viti Akademik: 2018-2019

Semestri i dytë

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Asoc. Dr. Nevila Baci

Janar, 2019

Pedagogu: Prof.Dr. Kozeta Sevrani, Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli
Adresa Elektronike e pedagogut të lëndës në FEUT: kozetasevrani@feut.edu.al,
ezmoldabarolli@feut.edu.al
Ngarkesa: 6 ETCS, 4 Orë në javë; 2 (Leksion), 2 (Seminar)
Semestri: II
Lloji i lëndës: e detyrueshme

PËRSHKRIM I LËNDËS:

Kjo lëndë është projektuar të ndihmojë studentët në rrugën e projektit të kërkimit shkencor. Ajo i ofron një guidë të qartë për mënyrën se si të ndërmerret kërkimi shkencor. Gjithashtu lënda është e organizuar në mënyrë të tillë që studenti të mësojë hap pas hapi të gjitha fazat e kërkimit shkencor që nga të menduarit e temës së kërkimit shkencor deri tek shkrimi i tezës përfundimtare. Ajo trajton metodat, strategjitë dhe filozofitë mbi të cilat duhet të mbështetet kërkimi. Trajton teknikat dhe procedurat e mbledhjes së të dhënave dhe analizimin e tyre. Mbi të gjitha thekson mënyrën se për çdo zgjedhje që bën kërkuesi duhet të justifikojë pse është ajo e duhura.

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E LËNDËS:

Moduli “Metodat e kërkimit” ka për qëllim kryesor të pajisë studentët e vitit të parë të masterit shkencor të Fakultetit të Ekonomisë me njohuritë e nevojshme për metodat e kryerjes së kërkimit shkencor dhe përdorimin e tyre në mënyrë efektive për të shkruar një mikrotezë ose për të ndërmarrë një projekt kërkimor si dhe ti japë mundësi studentit që të fitojë cilësi menaxheriale që do ta ndihmojnë për zgjedhjet në karrierën profesionale.

Në fund të kursit studenti kalues duhet të ketë arritur objektivat e mëposhteme:

- Të kuptojë konceptet bazë që lidhen me Metodat e Kërkimit në Sisteme Informacioni.
- Të kuptojë qëllimin dhe fokusin e kërkimit shkencor.
- Të kuptojë fazat e procesit të kërkimit.
- Të shkruajë draftin e propozimit të kërkimit.
- Të kuptojë rëndësinë dhe qëllimin e rishikimit kritik të literaturës.
- Të jetë në gjendje të zgjedhë strategjinë më të përshtatshme për kërkim.
- Të tregojë aftësitë për përdorimin e teknikave të ndryshme sasiore dhe cilësore në kërkim dhe të justifikojë zgjedhjen përkatëse.
- Të shkruajë disertacionin final.

METODOLOGJIA E MËSIMIT DHE MATERIALET E KURSIT

Në këtë seksion përmenden metodat e mësimdhënies që do të përdoren në këtë kurs, duke përfshirë leksionet, seancat e ushtrimeve dhe diskutimeve në seminare, si dhe prezantimin e

diskutimin e materialeve të marra nga literatuara apo shtypi. Studentët pritët që të luajnë një rol aktiv në diskutimet në klasë dhe seancat e zgjidhjes së problemeve.

Leksionet dhe Seminaret

Materiali bazë për kursin do të jenë leksionet dhe seminarët në klasë (shënimet e studentëve), prezantimet powerpoint të përdorura nga lektori për secilin leksion, të shoqëruara me referencat në literaturën bazë. Mësimi duhet të jetë interaktiv. Gjatë zhvillimit të seminareve theksi vendoset në përsëritjen, kuptimin logjik, konsolidimin e njohurive teorike të marra në leksione dhe mbi të gjitha zhvillimin e aftësisë për zbatimin praktik të tyre nëpërmjet zgjidhjes dhe analizës së problemeve të ndryshme.

Teste dhe Punë Individuale

Detyra shtëpie në formën e artikujve apo rasteve të studimit do të jepen për të ndihmuar studentin që të përvetësojë materialin e kursit dhe të përgatitet për provimin. Rastet e studimit do t'ju japin studentëve mundësinë që të ushtrohen dhe përmirësojnë aftësitë e komunikimit me shkrim ose verbal nëpërmjet prezantimeve në klasë. Teste të rastësishme do të organizohen për të lejuar pedagogët të kuptojnë progresin e kursit. Komunikimi interaktiv në formë elektronike do të orientojë studentët tek shumë materiale dhe burime të tjera informacioni. Materiale online ndihmëse për t'u përgatitur për kursin përfshijnë prezantimet powerpoint, artikuj, raste studimi, etj.

Komunikimi me Studentët dhe Konsultimet

Komunikimi me studentët do të realizohet në klasë si nëpërmjet diskutimeve ashtu edhe rasteve studimore për të testuar se sa i kanë kuptuar materialet e kursit. Studentët mund të komunikojnë gjithashtu me pedagogët e lëndës gjatë orareve të caktuara për konsultim. Nëse gjatë zhvillimit të kursit do të kenë ndonjë pyetje, apo do të kenë nevojë për ndihmë individuale, mund të kërkojnë një takim në një nga oraret e konsultimit të shpallura.

Frekuentimi

Frekuentimi i leksioneve, seminareve dhe punëve laboratorike: është i detyrueshëm në masën 75%. Kur studenti ka marrë pjesë në 50%-75% nuk ka të drejtë të hyjë në provimin e radhës por kalon në sezonin e vjeshtës. Kur studenti ka marrë pjesë në më pak se 50% të tyre, ai përsërit lëndën në vitin e ardhshëm. Detyra e Kursit është e detyrueshme për tu mbrojtur, në të kundërt studentin nuk mund të hyjë në provim.

KODI I ETIKËS

Ky kurs do të zhvillohet në përputhje me rregullat e specifikuar në Rregulloren e UT, rregulloren e FE dhe Kodin e Etikës së Fakultetit të Ekonomisë, të cilat obligojnë zero-tolerancë ndaj pandershmërisë akademike.

VLERËSIMI DHE KONTROLLI I DIJEVE

Vlerësimi i dijeve të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm të vlerësuar me pikë (në total 100 pikë):

1. Provim i ndërmjetëm dhe përfundimtar me shkrim (55% - 60%);
2. Aktivizimi dhe niveli i diskutimit, detyra kursi, projekte etj (40%-45%), më të detajuara janë paraqitur më poshtë;
 - a. Detyra shtëpie (aktivitet në grup) - Do të ketë disa detyra shtëpie gjatë semestrit. Ato do të jenë kryesisht kritikë për artikuj shkencorë që studentët do të lexojnë gjatë semestrit. (8 pikë)
 - b. Detyrë Kursi 1 – Propozim Projekti (Aktivitet në Grup) Për këtë detyrë do t'ju përcaktohet një temë për secilin grup të cilën do ta trajtojnë në formën e një detyre rreth 5-6 faqe dhe do ta prezantojnë në klasë për një kohë 10-15 minuta. (12 pikë)
 - c. Detyrë Kursi 2 – Artikull i plotë (Aktivitet në Grup) - Për këtë detyrë do të shkruani një punim ose artikull bazuar tek propozimi që bëni në Detyrë Kursit 1, do të fokusoheni kryesisht tek rishikimi i literaturës por jo vetëm, rreth 10 faqe dhe do ta prezantoni gjithashtu në klasë për një kohë 10-15 minuta. (15 pikë)
 - d. Pjesmarrje aktive në seminar/Teste (Aktivitet Individual) - Testet do të zhvillohen në klasë. Për këtë do të ketë 5 detyra të tilla të cilat do të vlerësohen me pikë. (10 pikë)

Studentit i shtohen vlerësimet vjetore të përfshira në pikën 2, n.q.s. ai merr të paktën 40% të pikëve të secilit prej dy provimeve me shkrim të përfshira në pikën 1.

<i>Nota 4</i>	<i>deri në 50 pikë</i>
<i>Nota 5</i>	<i>51 - 57</i>
<i>Nota 6</i>	<i>58 - 65</i>
<i>Nota 7</i>	<i>66 - 73</i>
<i>Nota 8</i>	<i>74 - 81</i>
<i>Nota 9</i>	<i>82 - 89</i>
<i>Nota 10</i>	<i>90 – 100</i>

PËRMBAJTJA E LËNDËS

1. Natyra e kerkimit ne biznes dhe menaxhim
2. Formulimi dhe sqarimi i ceshtjeve të kerkimit
3. Shikimi kritik i literatures
4. Të kuptuarit e filozofise se kerkimit dhe perafirimet e mundeshme
5. Formulimi i dizajnit të kerkimit
6. Negocimi i aksesit dhe etiket kerkimore
7. Zgjedhja e kampionit
8. Perdorimi i të dhenave dytesore
9. Grumbullimi i të dhenave paresore nëpërmjet vrojtimit
10. Grumbullimi i të dhenave paresore me ane të intervistimeve gjysem të strukturuara, ne thellesi dhe ne grup
11. Grumbullimi i të dhenave paresore duke perdorur pyetsoret
12. Analizimi i të dhenave sasijore

13. Analizimi i të dhënave cilësore
14. Shkrimi dhe paraqitja e raportit të projektit

LITERATURA

- **Literatura bazë:**
Research Methods For Business Students, by M. Saunders, Ph. Lewis and A. Thornhill,
Pearson Education, 5th edition 2009
- **Literatura plotësuese:**
Business Research Methods. B. Blumberg, D.R. Cooper and P.S. Schindler, P.S. McGraw Hill
10/e 2008
Essential of Research Design and Methodology – G. Marczyk, D. DeMatteo, D. Festinger,
John Wiley & Sons, Inc, 2005
- **Faqe internet:**
Website me informacione të vlefshme për kërkimin shkencor në fushën e Sistemeve të
Informacionit do të vihen në dispozicion të studentëve.